

Shfrytëzues

Shfrytëzuesit janë fermat që kanë përmbushur kriterët e programit dhe kanë kapacitetet maksimale si më poshtë:

- fidane rushi dhe pemishte deri në 5 ha,
- kulturat kopshtare deri në 2ha,
- duhan deri në 1ha,
- drithëra deri në 10ha,
- familje bletësh deri në 100.

Procedura për marrjen e mbështetjes financiare

- Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve me dokumentacionin e kërkuar dorëzohet në zyrat rajonale të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ujrave deri më datë 30.08.2012.
- Njësia rajonale bazuar në të dhënat e Regjistrit të vetëm, bujkut i jep Vërtetim për posedimin e kapaciteteve bujqësore dhe të njejtin ia dorëzon aplikantit.
- Aplikanti, vërtetimin ja dorëzon shoqërisë së sigurimit.
- Shoqëria e sigurimit lëshon Policën e sigurimit.
- Një kopje të Policës, aplikanti e kthen në njësinë rajonale me çka e plotëson dosjen e vetë.
- APFBZHR** pas verifikimit të përputhshmërisë me kriterët e përcaktuara në program do të kryjë pagesën sipas faturës në llogari të shoqërisë së sigurimit, në përfitim të aplikantit dhe atë në vlerë prej 60% nga vlera e përgjithshme e Policës.
- Aplikanti mbështetjen financiare për prodhimin bujqësor mund ta sigurojë në shoqërinë e sigurimit sipas zgjedhjes së tij.

Kontakt:

Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimit

Rr. "Vasil Glavinov" Nr. 12

TCC PLAZA, kati i 2-të

1000 Shkup, Maqedoni

Tel: 02 3254 050

Faks: 02 3290 240

e-posta: contact@aso.mk

www.aso.mk

Orari i punës nga ora 08:30 deri 16:30

Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural

Rr. "Treta Makedonska Brigada" nr. 20,

ndërtesa, Maqedonia Tabak, bloku C

1000 Shkup, Maqedoni


Telefon/Faks: 02 3097 450 / 02 3097 454

e-posta: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

www.ipardpa.gov.mk

Orari i punës nga ora 08:30 deri 16:30

MBROJENI PUNËN TUAJ



AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

SIGURIMI NË BUJQËSI



Prodhuesit e produkteve bujqësore përballen me rreziqe të lidhura me kushtet e motit, fatkeqësive natyrore, dëmtuesve dhe sëmundjeve.

Blerja e policave për sigurim bujqësor është mënyra më efektive për kompenzimin e dëmit nga humbjet.

Çka paraqet polica e sigurimit në prodhimet bujqësore?

Polica e sigurimit është dokument i shkruar, marveshje për sigurim në mes **bujkut (i siguruar) dhe shoqërisë së sigurimit (sigurues).**

Pas marëveshjes për sigurim, **shoqëria e sigurimit kanë detyrim që siguruarit t'i dorëzojë të a.sh. Kushtet e sigurimit** të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e siguruesit dhe të siguruarit.

Çka mundet të sigurohet te produktet bujqësore dhe nga cilat rreziqe?

Bujqit mund të sigurojnë

- Të mbjellurat dhe frutat
- Kafshët

Sigurimi i të mbjellurave dhe frutave mund të mbulojë rreziqe nga kërcenimet, siç janë: breshër, zjarr, rufe, përmytjet dhe stuhia.

Sigurimi i kafshëve mund të mbulojë rreziqe ngatë ngordhurit, aksidentët, qëndrim në karantin, ekspozitë të kafshëve, etj.

Kush mund të shesë polica sigurimi?

- **Shoqëria e sigurimit (në zyrat e tyre apo nëpërmjet agjentëve në teren),**
- **Shoqëri brokere të sigurimit,**
- **Shoqëri agjente të sigurimit.**

Cilat janë obligimet e shoqërisë së sigurimit?

Shoqëria e sigurimit është e detyruar të paguaj dëmin.

Nëse nuk shprehet ndryshe, fillon pas 24 orëve nga dita ku është shënuar fillimi i sigurimit në policën e sigurimit.

Cilët janë detyrimet e bujkut nga kontraktimi i policës së sigurimit?

Bujku është i detyruar të paguaj primin e sigurimit.

Bujku është i detyruar për të marrë gjithëçka në fuqinë e tij për të parandaluar ndodhjen e ngjarjs së siguruar.

Në rast se ndodh dëmi, dëmi i njejtë **duhet të raportohet në shoqërinë e sigurimit**

Cila është procedura për raportimin e dëmit?

- Bujku dorëzonë kërkesë për zhdëmtim.
- Shoqëria e sigurimit identifikon dhe vleron dëmin.
- Me kërkesë të shoqërisë së sigurimit, bujku është i detyruar të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me listën e dokumentacionit të kërkuar nga siguruesi, që dëmi të përpunohet dhe të zgjidhet.
- Vlersuesi-eksperti bujqësor, shkon në teren ku kryhet vlersimi i drejtpërdrejt i kulturave bujqësore të dëmtuara për të përcaktuar shumën e kompenzimit konform policës së sigurimit.
- Pas përcaktimit të shumës së kompenzimit nga ana e vlersuesit, siguruesi sjell vendim përfundimtarë për shumën e cila do t'i paguhet të siguruarit (bujkut).
- Shoqëria e sigurimit e njofton bujkun se vendimi ka detyrim ligjor që në afat prej 14 ditëve të kompenzohet dëmin.

A janë të drejtat dhe interesat e mia si i siguruar (shfrytëzues sigurimi) të mbrojtura në mënyrë adekuate

- Në qoftë se bujku nuk është dakord me shumën e caktuar si kompenzim të dëmit, ka mundësi që të dërgoi ankesë.
- Nëse siguruesi e refuzon ankesën pa shpjegim adekuat, bujqit të drejtat e tyre mund të i kërkojnë para gjykatës kompetente.
- Gjithashtu, bujku ka të drejtë ankesën ta dorëzojë deri në **Agjencinë për mbikëqyrjen e sigurimeve (AMS)**. Bujku ka të drejtë që ankesën ta dorëzojë në AMS nëse paraprakishtë me shkresë është drejtuar deri te siguruesi dhe nuk është i kënaqur me përgjigjen, ose siguruesi nuk ka marë vendim për ankesën në afat prej 30 ditëve në dërgesën e të njejtës.

Subvencionimin e primeve të sigurimit

Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural (APFBZHR) e implementon Programin për mbështje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural. Një nga masat e parashikuara është ndihma financiare për subvencionimin e primeve në sigurimin bujqësor.

Shuma e ndihmës nuk do të tejkalojë 60% të kostos së primit të sigurimit për kompensimin e dëmit në prodhimin primar ndodhur si rezultat i fatkeqësive natyrore, por jo më shumë se 200.000 denarë për fermë.

